



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 062/5
Prishtinë, më 26 shkurt 2009
Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 26 SHKURT 2009**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 86 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në fillim të seancës, për fjalën u paraqitën këta deputetë:

Deputeti **Gani Geci** paraqiti shqetësimet e Grupit Parlamentar të LDD-së lidhur me grevën e punonjësve të shëndetësisë. Ai propozoi që Kuvendi, në seancën e sotme ta shqyrtojë si çështje të ngutshme edhe gjendjen në sistemin shëndetësor të Kosovës.

Deputetja **Gjylanze Syl**a mbështeti propozimin e deputetit Gani Geci që në seancën e sotme të debatohet edhe për gjendjen e shëndetësisë.

Deputeti **Ibrahim Makolli** mbështeti propozimin e deputetit Geci që në seancën e sotme të debatohet për gjendjen në sistemin e shëndetësisë. Ai propozoi që Kuvendi të debatohet edhe për vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës lidhur me ankesat e Shërbimit Civil të Kosovës, të cilat nuk po zbatohen nga ana e organeve dhe e agjencive ekzekutive.

Deputeti **Shkumbin Demaliaj** tha se në qoftë se në seancën e sotme debatohet për grevat e punëtorëve të shëndetësisë dhe për gjendjen në shëndetësi, atëherë paraprakisht komisioni funksional i Kuvendit duhet ta paraqesë një raport lidhur me këtë.

Kryetari i komisionit funksional, **Sadik Idriz**, tha se Komisioni ka mbajtur mbledhje, në të cilën është diskutuar për grevën e punonjësve të shëndetësisë. Ne kemi vendosur që të shkojmë te punëtorët shëndetësorë dhe të njihemi me problemet dhe kërkesat e tyre. Por, sa i përket propozimit për rritjen e pagave, kjo është çështje me të cilën duhet të merret Qeveria.

Deputeti **Naser Rugova** tha se greva e organizuar nga ana e punonjësve të shëndetësisë është si pasojë e moszbatimit të Marrëveshjes ndërmjet tyre dhe Qeverisë së Kosovës, e cila është nënshkruar vitin e kaluar.

Deputeti **Riza Smaka** kërkoi nga Qeveria e Kosovës që ta hartojë dhe Kuvendit t'ia procedojë Projektligjin mbi pagat.

Kryetari tha se për të gjitha çështjet e ngritura deputetët duhet t'i parashtrajnë kërkesat me shkrim për t'u proceduar për shqyrtim në Kuvend.

Ministri **Ahmet Shala**, në emër të Qeverisë së Kosovës, propozoi që të tërhiqet nga rendi i ditës Projektligji për raportimin financiar të organizatave të biznesit.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, deklaroi se mbështet propozimin e sponsoruesit që të tërhiqet nga shqyrtimi Projektligji për raportimin financiar të organizatave të biznesit.

Kryetari hodhi në votim propozimin e ministri Shala. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për..... shumica absolute,
Kundër..... 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi propozimin e sponsoruesit që të tërhiqet nga procedura e shqyrtimit Projektligji për raportimin financiar të organizatave të biznesit.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 12 dhe 13 shkurt 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore,
6. Shqyrtimi i Projekt-Rezolutës për prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për integrim në Unionin Evropian dhe Planin i veprimit për sfidat e Raportit të Komisionit Evropian për progresin në Kosovë,
7. Shqyrtimi i Raportit të Trustit të Kursimeve Pensionale për tremujorin e katërt të vitit 2008,
8. Shqyrtimi i Projekt-Strategjisë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011,
9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 12 dhe 13 shkurt 2009

Kuvendi miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 12 dhe 13 shkurt 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Donika Kadaj-Bujupi** parashtroi pyetje për ministrin e Arsimit, Enver Hoxhaj, lidhur me kontratat e nëntë profesorëve në paralelen e shkollës së mesme ne burgun e Dubravës.

Ministri Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Bujupi.

Deputeti **Naim Rustemi** parashtroi pyetje për ministren e Energjisë dhe të Minierave, Justina Shiroka Pula, lidhur me humbjet e shkaktuara KEK-ut nga kompania Alferon.

Ministrja Pula iu përgjigj pyetjes së deputetit Rustemi.

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje për ministrin e Arsimit, Enver Hoxhaj, lidhur me Fondin Nacional për Arsim.

Ministri Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja **Sala Berisha Shala** parashtroi pyetje për ministren e Energjisë dhe të Minierave, Justina Shiroka Pula lidhur me furnizimin me energji elektrike në Kosovë.

Ministrja Pula iu përgjigj pyetjes së deputetes Shala..

Deputetja **Zylfije Hundozi** i parashtroi pyetje për ministrin e Bujqësisë, Idriz Vehapi, lidhur me rregullimin e sektorit të verërave.

Ministri Vehapi iu përgjigj pyetjes së deputetes Hundozi.

Deputetja **Zylfije Hundozi** parashtroi pyetje për ministrin e Arsimit, Enver Hoxhaj, lidhur me integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla.

Ministri Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Hundozi.

Deputetja **Zylfije Hundozi** parashtoi pyetje për ministrin e Ambientit dhe të Planifikimit Hapësinor, Mahir Yagcilar, lidhur me realizimin e 52 projekteve të Planit të veprimtimit për mjedis 2007-2010.

Ministri Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Hundozi.

Deputeti **Berat Luzha** i parashtoi pyetje ministres së Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, lidhur me çështjen e Remzi Hoxhës, i zhdukur në Tiranë.

Ministrja Nekibe Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetit Luzha.

Deputetja **Myrvete Pantina** parashtoi pyetje për ministrin e Ambientit dhe të Planifikimit Hapësinor, Mahir Yagcilar, lidhur me mbrojtjen e lumit Sitnicë nga ndotësit.

Ministri Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Pantina.

Deputeti **Driton Tali** parashtoi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me kontratën në mes të kompanisë Dardafon dhe PTK-së.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis

Kryesuesi i seancës, **Xhavit Haliti**, i njoftoi deputetët me procedurat e shqyrtimit të këtij Projektligji, si dhe me raportet dhe rekomandimet e komisioneve parlamentare.

Kryetari i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për57,
Kundër..... 0,
Abstenime..... 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit

Kryesuesi i njoftoi deputetët me procedurat e shqyrtimit të këtij Projektligji, si dhe me raportet dhe rekomandimet e komisioneve parlamentare.

Kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36 dhe 37.

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për70,
Kundër..... 0,
Abstenime..... 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për mbrojtjen e mjedisit.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandim.

Ai ftoi përfaqësuesin e Komisionit që ta arsyetojë raportin.

Kryetari i komisionit funksional, **Lulzim Zeneli** tha se Komisioni Parlamentar për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar Projektligjin në fjalë dhe pas konsultimeve që ka pasur edhe me ekspertë vendorë, ndërkombëtarë, me përfaqësuesit e Ministrisë, me organizatat të cilat e kanë ndihmuar punën e Kuvendit të Kosovës, gjegjësisht të komisionit parlamentar, ka konstatuar se ky Projektligj nuk mund të adresojë të gjithë atë problematikë të cilën ngërthen në vete vetë titulli i këtij Projektligji. Prandaj, Komisioni i rekomandon Kuvendit të Kosovës që këtë projektligj t'ia kthejë sponzoruesit, për rihartim.

Ministri **Mahir Yagcilar** tha se Qeveria e Kosovës mbështet rekomandimet e komisionit funksional që Projektligji të kthehet për rihartim.

Kryesuesi e hodhi në votim rekomandimin e komisionit funksional. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për55,
Kundër..... 3,
Abstenime..... 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Kuvendi nuk miratoi Projektligjin nr.03/L-030 për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore.
2. Projektligji i kthehet Qeverisë së Kosovës, për rihartim.

6. Shqyrtimi i Projekt-Rezolutës për prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për integrim në Unionin Evropian dhe Plani i veprimit për sfidat e Raportit të Komisionit Evropian për progresin në Kosovë

Kryesuesi njoftoi deputetët se Komisioni për Integritet Evropian ka hartuar Projekt-Rezolutën për prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për integrim në Unionin Evropian dhe Planin e veprimit për sfidat e Raportit të Komisionit Evropian për progresin në Kosovë dhe Kuvendit ia ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim.

Ai ftoi kryetaren e Komisionit që ta paraqesë Projekt- Rezolutën.

Kryetarja e Komisioni për Integritet Evropian, **Zylfije Hundozi**, në emër të Komisionit paraqiti tekstin e Projektrezolutës, si vijon:

REZOLUTË

PËR PRIORITETET DHE STRATEGJITË E KOSOVËS PËR INTEGRIM NË BASHKIMIN EVROPIAN

Duke marrë parasysh qëllimin strategjik dhe pajtimin e plotë të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian,

Me synim ndërtimin e shtetit të bazuar në sundimin e ligjit, me ekonomi të qëndrueshme dhe demokraci funksionale të mundësive të barabarta për të gjithë, në pajtim me vlerat dhe parimet e familjes Evropiane,

Duke shprehur gatishmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës për të përmbushur standardet evropiane si kushte për anëtarësim në Bashkimin Evropian,

Duke vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm të institucioneve të Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian dhe praninë ndërkombëtare në Kosovë dhe duke u zotuar për bashkëpunim më të ngushtë në të ardhmen,

Duke vlerësuar bashkëpunimin ndërparlamentar mes Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit Evropian dhe duke u zotuar për bashkëpunim më të ngushtë,

Duke marrë parasysh arritjet e deritashme në Procesin e Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim Asociimit të iniciuara në vitin 2004 dhe të vetëdijshëm mbi sfidat që na presin për arritjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian,

Duke qenë të vetëdijshëm se kriteret e përcaktuara nga ana e Këshillit Evropian në Kopenhagë, më 1993, dhe në Madrid, më 1995, janë esenciale për anëtarësim në Bashkimin Evropian,

Duke marrë parasysh se vlerësimet e dala nga Raportit i Progresit të Kosovës për vitin 2008 i përgatitur nga Komisioni Evropian, marrë në përgjithësi, janë reale, si dhe nevojën për të trajtuar sfidat e përcaktuara në këtë Raport,

Duke vlerësuar se qëllim parësor i Republikës së Kosovës për vitin 2009 është avancimi i proceseve të integrimeve evropiane, me theks të veçantë arritjen e vlerësimeve pozitive të Raportit të fizibilitetit nga ana e Komisionit Evropian,

Duke u thirrur në Planin e Veprimit për Partneritet Evropian të Kosovës, përfundimet e Seancës plenare të 11 dhjetorit 2008 dhe orientimin afatgjatë të institucioneve të Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian,

Kuvendi i Republikës së Kosovës

1. Rikonfirmon zotimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për përmbushjen e standardeve të kërkuara për integrim në Bashkimin Evropian;
2. Zotohet se do të intensifikojë përpjekjet në përmbushjen e kërkesave të procesit të Stabilizim Asociimit, të cilat shpien në nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit;
3. Vazhdon zotimet për garantimin e zbatimit të plotë të parimeve të sundimit të ligjit, ekzistimin e institucioneve demokratike, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, të ekonomisë konkurruese të tregut, të kapacitetit për t'u përballur me presionet konkurruese dhe të forcave të tregut brenda Bashkimit Evropian, të zbatimit të parimeve kryesore të *acquis communautaire*, si dhe të bashkëpunimit me shtetet tjera të rajonit, siç është përcaktuar nga Kriteret e Kopenhagës, më 1993, dhe të Madridit, më 1995;
4. Rikonfirmon gatishmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës për thellimin e bashkëpunimit me Bashkimin Evropian dhe praninë ndërkombëtare në Kosovë, me synim të fuqizimit të pozitës së Kosovës në proceset e integrimit evropian;
5. Kërkon nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që të koordinojnë përpjekjet e tyre drejt përmbushjes së rekomandimeve të përcaktuara në *“Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2008, shoqëruar me Komunikatën e Komisionit Evropian drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës mbi “Strategjinë e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2008-2009”*, si dokument kryesor për Integrimin Evropian të Kosovës;
6. Konsideron se ndër prioritetet kryesore për vitin 2009 të të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës është fuqizimi i dimensionit evropian në Kosovë, që do të ndikojë në arritjen e vlerësimit pozitiv nga Komisioni Evropian në Raportin e fizibilitetit;
7. Shpreh gatishmërinë për bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit Evropian në të gjitha nivelet;
8. Mbetet i përcaktuar në arritjen e sundimit të ligjit përmes reformave të sistemit të gjyqësisë, plotësimit të kornizës institucionale dhe zbatimit të të gjitha ligjeve bazuar në parimin ‘askush nuk është mbi ligjin’;
9. Konstaton rëndësinë e jashtëzakonshme të stabilitetit në Kosovë dhe kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të shtrijë autoritetin e saj në tërë territorin me synim të integrimit të të gjitha komuniteteve në shoqërinë e Kosovës;
10. Thekson se zhvillimi ekonomik është prioritet kyç dhe shpreh përkrahjen e plotë për të gjithë aktorët ekonomikë, publikë dhe privatë, tërheqjen e investimeve të drejtpërdrejta të huaja, që do të rezultojnë me krijimin e mundësive të punësimit dhe përmbylljen transparente të procesit të privatizimit;
11. Kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që t'i intensifikojë përpjekjet e saj në reformimin e administratës publike bazuar në parimin e një administrate publike bashkëkohore dhe efektive pa ndërhyrje politike;
12. Kërkon nga institucionet e Republikës së Kosovës që të ndërmarrin veprime vendimtare për luftimin e fenomeneve negative në mënyrë që të përmbushen kërkesat e Kapitullit të

Drejtësisë, të Lirisë dhe të Sigurisë të Raportit të Progresit për vitin 2008 për Kosovën, duke përfshirë korrupsionin, krimin e organizuar dhe evazionin fiskal;

13. Angazhohet për strategji të përbashkëta me Qeverinë e Republikës së Kosovës për realizimin e Standardeve Evropiane të Tregut të Brendshëm, siç përcaktohet në Raportin e Progresit për vitin 2008 për Kosovën, duke përfshirë konkurrencën, edukimin dhe hulumtimin, prokurimin publik, doganat dhe tatimet;
14. Angazhohet për strategji të përbashkëta me Qeverinë e Republikës së Kosovës për realizimin e Standardeve Evropiane të Politikave Sektoriale, siç përcaktohet në Raportin e Progresit 2008 për Kosovën, siç janë politika për energji, mjedis, industri dhe ndërmarrje të vogla dhe të mesme, transport, informim dhe media, statistika, kontroll financiar, bujqësi dhe peshkatari;
15. Kërkon nga Komisioni Parlamentar për Integritet Evropian përmbushjen e detyrave dhe të obligimeve të dala nga përfundimet e Seancës plenare të 11 dhjetorit 2008 për analizimin, planifikimin, raportimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Veprimit të Kuvendit për sfidat e Raportit të Progresit 2008 për Kosovën. Po ashtu, fton të gjitha komisionet parlamentare që të angazhohen tërësisht në realizimin e Planit të Veprimit;
16. Angazhohet për një strategji koherente dhe harmonizim të agjendës legislative përmes bashkërendimit ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës, në veçanti duke marrë parasysh sfidat e dala nga Raporti i Progresit 2008.
17. Fton Qeverinë e Republikës së Kosovës që rregullisht dhe në mënyrë përmbajtjesore të njoftojë Kuvendin e Republikës së Kosovës për progresin e arritur dhe komunikimin me institucionet e Bashkimit Evropian;
18. Përkushtohet për mbikëqyrjen e procesit të zbatimit të obligimeve të sipërpërmendura nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Plani i veprimit ngërthen në vete një qasje më aktive të Kuvendit përballë procesit të integrimit evropian, duke përdorë në mënyrë efikase mjetet parlamentare të mbikëqyrjes ndaj Qeverisë.

Në këtë plan, pos Komisionit për Integritet Evropian, edhe komisionet tjera parlamentare do të përfshijnë në agjendën e tyre të takimeve të rregullta sfidat e integrimit evropian.

Komisioni për Integritet Evropian e ka marrë mandatin nga seanca plenare për koordinim të veprimeve. Komisionet tjera parlamentare i dërgojnë informacione rregullisht për hapat e marrë dhe për progresin e arritur. Komisioni për Integritet Evropian çdo 3 muaj do t'i raportojë seancës plenare për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit për sfidat e Raportit të progresit për vitin 2008.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Projekt- Rezolutën dhe Planin e veprimit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Projekt-Rezolutën për prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për integrim në Unionin Evropian dhe Planin e veprimit për sfidat e Raportit të Komisionit Evropian për progresin në Kosovë dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Bujar Bukoshi**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Njomza Emiri**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Naser Rugova**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sadik Idriz**, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Bojan Stojanović** dhe në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, **Branislav Grbić**, si dhe deputetët: **Edita Tahiri**, **Fatmir Rexhepi**, **Gjylnaze Sylaj**, **Ramadan Avdiu**, **Riza Smaka**, **Gani Bućinca**, **Nekibe Kelmendi**, **Driton Tali**, **Hajdin Abazi**, **Sanije Alija**, **Bahri Hyseni**, **Berim Ramosaj**,

Ibrahim Makolli, Myzejene Selmani, Gani Koci dhe Ismet Beqiri, që janë dhënë në Transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Në fund, Kryetari hodhi në votim Projekt- Rezolutën dhe Planin e veprimit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----38,
Kundër----- 4,
Abstenime-----12.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Rezolutën për prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për integrim në Unionin Evropian dhe Planin e veprimit për sfidat e Raportit të Komisionit Evropian për progresin në Kosovë.

7. Shqyrtimi i Raportit të Trustit të Kursimeve Pensionale për tremujorin e katërt të vitit 2008

Kryetari i njoftoi deputetët me Raportin dhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale për tremujorin e katërt të vitit 2008.

Ai ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, që ta arsyetojë raportin.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci e arsyetoi Raportin e komisionit para deputetëve të Kuvendit.

Kryetari hapi debatin lidhur Raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale për tremujorin e katërt të vitit 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale për tremujorin e katërt të vitit 2008 dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Berim Ramosaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Mufera Sinik, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović dhe në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, Branislav Grbiq, që janë dhënë në transkript.

Gani Koci, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, propozoi që kjo pikë të shtyhet për seancën tjetër të radhës me arsyetimin se Trusti ndërkohë e kishte dërguar edhe raportin për punën njëvjeçare të tij dhe ky raport i kompletuar të shqyrtohet në një seancë.

Kryetari hodhi në votim propozimin e Gani Kocit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----38,
Kundër-----20,
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që shqyrtimi i Raportit të Trustit të Kursimeve Pensionale të shtyhet për seancën tjetër të radhës.

8. Shqyrtimi i Projekt-Strategjisë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011

Kryetari i njoftoi deputetët se Qeveria e Republikës së Kosovës e ka proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend Projekt-Strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011.

Ai ftoi kryetarin e komisionit funksional ta paraqesë qëndrimin e Komisionit lidhur me Projekt-Strategjinë kundër korrupsionit.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, tha se Komisioni e ka shqyrtuar Projekt-Strategjinë kundër korrupsionit për vitin 2009-2011.

Konsiderojmë se Agjencia Kundër Korrupsionit ka hartuar një strategji e cila i plotëson të gjitha kriteret dhe shpresojmë se me gatishmërinë e institucioneve të cilat janë përfshirë në këtë dokument, do ta luftojmë këtë dukuri negative.

Kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, **Rrustem Mustafa**, tha se nuk ka mandat të krijojë politika antikorrupsion, por t'i zbatojë politikat antikorrupsion, që i përcakton Kuvendi i Kosovës me aktet konkrete, siç është Strategjia dhe Plani i veprimit antikorrupsion.

Projekt-Strategjia është një dokument shumë përshkrues, nga 16 faqe sa ka, gjithsej gjysma, domethënë 8 faqe përbëjnë parime përshkruese dhe vështirime. Vetëm 8 prej tyre janë objektiva të përgjithshme dhe specifike. Nuk është bërë një studim paraprak për nevojat dhe sektorët prioritarë në të cilët ka nivel të korrupsionit më të lartë ndaj të cilëve kërkohet një fokusim më i madh.

Objektivat e përcaktuara në Projekt-Strategji shpeshherë janë shumë të përgjithësuara dhe të paqarta, nganjëherë nuk janë në sektorin e duhur, ka një ngatërrim në definimin dhe përcaktimin e tyre.

Ne, në Komision jemi pajtuar që në parim ta mbështesim këtë Strategji, mirëpo duhet plotësuar dhe kësaj t'i bashkëngjitet edhe Plani i veprimit dhe së bashku të miratohen në Kuvend.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Projekt-Strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011 dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović dhe në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, Branislav Grbić, si dhe deputetët: Hajdin Abazi, Armend Zemaj, Donika Kadaj-Bujupi, Kaqusha Jashari, Myrvete Pantina, Gani Geci, Naser Rugova, Riza Smaka, Suzanë Novobërdaliu, Edita Tahiri, Gjylnaze Syla, Qamile Morina, Gani Koci, Rita Hajzeraj, Shkumbin Demaliaj dhe Sabri Hamiti, që janë dhënë në Transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari hodhi në votim miratimin e Projekt-Strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----29,
Kundër-----30,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Kuvendi nuk miratoi Projekt-Strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011.

9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Në mungesë të ministres së Drejtësisë, zonjës Nekibe Kelmendi, me propozimin e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit, Eqrem Kryeziu, Kuvendi shtyu shqyrtimin e Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale për seancën tjetër të radhës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 18:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**